



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 qershor 2014
Nr.ref.:RK660/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

né

Rastin Nr. KI54/14

Parashtrues

Hamdi Ademi

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, të 26 nëntorit 2007, dhe Aktvendimit të Këshillit të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, nr. 5054321, të 10 nëntorit 2005

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Hamdi Ademi, nga fshati Gllamnik, komuna e Podujevës, i cili përfaqësohet nga z. Mahmut Hoti, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, të 26 nëntorit 2007 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), dhe Aktvendimin e Këshillit të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, nr. 5054321, të 10 nëntorit 2005 (në tekstin e mëtejmë: Këshilli i Ankesave i MPMS-së).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 375/2007, dhe Aktvendimit të Këshillit të Ankesave të MPMS-së, nr. 5054321, përkitazi me shkeljen e së drejtës për njohjen e statusit për pension të personave me aftësi të kufizuar.
4. Parashtruesi në kërkesën e tij nuk ka specifikuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Baza juridike është nen 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nen 20 dhe nen 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 mars 2014, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata)
7. Më 2 prill 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI54/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI54/14, caktoi Kolegjin shqyrtyes të përbërë nga gjyqtarët: Altay Surøy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 18 prill 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Supreme dhe MPMS-në, për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 19 maj 2014, Kolegji shqyrtyes shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përbledhja e fakteve

10. Më 17 qershor 2005, MPMS-së, përkatësisht instanca e parë, me Vendimin nr. 5054321, refuzoi kërkesën e parashtruesit për njohjen e të drejtës përfitimin e pensionit të personave me aftësi të kufizuar. Kjo instancë konstatoi se parashtruesi nuk i plotësonte kriteret sipas nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/40, mbi Ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuar. Arsyetimi për refuzimin e kërkesës së parashtruesit ishte mbështetur në

konstatimin e Komisionit mjekësor të 8 qershorit 2005, i cili kishte vlerësuar se te parashtruesi nuk ekziston kufizimi i përhershëm i aftësisë për punë, siç parashihet me dispozitën ligjore të lartcekur.

11. Parashtruesi, kundër vendimit në fjalë, në afat ligjor ushtroi ankesë tek Këshilli i Ankesave të MPMS-së.
12. Më 10 nëntor 2005, Këshilli i Ankesave i MPMS-së, me Aktvendimin nr. 5054321, refuzoi kërkesën e parashtruesit, përkitazi me njohjen e të drejtës së pensionit për persona me aftësi të kufizuar, për arsy se parashtruesi nuk kishte ofruar dëshmi për përbushjen e kritereve për të qenë përfitues i pensionit për persona me aftësi të kufizuar, siç përcakton nenit 3 i Ligjit për pensionet e personave me aftësi të kufizuar.
13. Parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme, kundër aktvendimit të Këshillit të Ankesave të MPMS-së, duke e kontestuar ligjshmërinë e aktvendimit në fjalë, për arsy se komisionet mjekësore nuk morën parasysh faktin se gjendja e tij shëndetësore ishte e rëndë dhe se ai nuk është më i aftë për punë, për çfarë edhe gjendja faktike, sipas tij, nuk u vërtetua në mënyrë të drejtë dhe të plotë.
14. Më 26 nëntor 2007, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin A. nr. 375/2007, me të cilin u refuzua padia e parashtruesit, me arsyetimin se:

[...]

“Duke pasur parasysh se komisionet mjekësore me ligj të autorizuara, kanë vërtetuar se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar për pune, gjykata konstaton se organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 3 të Ligjit të cekur më lart, në bazë të cilit edhe është refuzuar kërkesa e paditëses që t'i njihet e drejta në pension invalidor.

Gjykata vlerësoi theksimet e padisë dhe konstatoi se të njëjtat në këtë çështje administrative nuk kanë ndikim në vendosje tjetër, sepse me provat e administruara në vështrim të dispozitës së cekur ligjore pa mëdyshje është vërtetuar qe paditësi nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e së drejtës se kërkuar, prandaj në vështrim të nenit 42 par. 2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.

[...]

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, i 26 nëntorit 2007 dhe Aktvendimi i MPMS-së shkel të drejtat e tij për gëzimin e pensionit për persona me aftësi të kufizuar.
16. Parashtruesi i kërkesës kërkon, ndër të tjera, që të hidhet poshtë, si i pabazuar Aktvendimi i Këshillit të Ankesave të MPMS-së nr. 5054321, i 10 nëntorit 2005, dhe t'i njihet e drejta për përfitimin e pensionit të personave me aftësi të kufizuar.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të shqyrtoj kërkesën e parashtruesit, së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
18. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) h), i cili thotë:

“Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

*h) kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën”.*

19. Për të përcaktuar juridiksonin kohor të Gjykatës, është qenësore të identifikohet në secilin rast konkret koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Duke vepruar ashtu, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat ankohet parashtruesi dhe shtrirjen e të drejtës kushtetuese që pretendohet se është cenuar (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i Dhomës në rastin *Blečić kundër Kroacisë*, Kërkesa nr. 59532/o, e 8 marsit 2006, paragrafi 82).
20. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ankohet kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 375/2007, miratuar më 26 nëntor 2007, dhe Aktvendimit të MPMS-së. Prandaj, vendimi përfundimtar për parashtruesin është Aktgjykimi A. nr. 375/2007, i 26 nëntorit 2007.
21. Kjo do të thotë se shkelja e pretenduar e të drejtave të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me Kushtetutë, ka ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe nga e cila datë Gjykata ka juridikson kohor.
22. Gjykata ngjashëm ka vendosur në rastin KI100/10, Aktvendim për papranueshmëri, parashtruesi i kërkesës *Eduard Thaçi* (gjithashtu i njohur si Sokol Thaçi), Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Policisë së Kosovës, nr. 398-SHPK-2002, të 22 tetorit 2002.
23. Përfundimisht, rezulton që kërkesa e parashtruesit nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (3) h) si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores, më 19 maj 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues

Prof. dr. Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

